AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE KONFISKUARA

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
VITI 2026

Nr. Rend.	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1.	06.01.2026	**Kërkesë për informacion.** **1.Si i kategorizon dhe i vlerëson AAPSK provat materiale?**	08.01.2026	Përshëndetje, Gjeni bashkëlidhur informacionin e kërkuar të pasurive që janë aktualisht nën sekuestro ose të konfiskuara. Në bazë të Ligjit nr. 34/2019, pasuritë e sekuestruara ndahen sipas natyrës së tyre në: pasuri të paluajtshme, pasuri të luajtshme, shuma monetare, aksione/subjekte tregtare dhe prova materiale. Provat materiale përfshijnë mallra, pajisje, metale, sende me vlerë dhe materiale të sekuestruara në kuadër të procedimeve penale. Vlerësimi bëhet rast pas rasti, nga ekspertë të licencuar ose përmes çmimeve referencë apo vlerësimit sipas faqeve në internet, si dhe gjatë fazave të ankandeve publike nga	Me email	Pa pagesë

				ekpertët përkatës të fushës, në varësi të llojit të pasurisë. Gjithmonë ky vlerësim i referohet momentit me te volitshëm në bazë të vlerës së pasurisë dhe shpenzimit përkatës.		
		2. A ka një standard unik administrimi?		Jo. Ligji 34/2019 parashikon administrim të diferencuar sipas natyrës së pasurisë. AAPSK mund të administrojë drejtpërdrejt, të emërojë administratorë, ose të kontraktojë subjekte private për ruajtje dhe mirëmbajtje. Në rastet kur pasuria rrezikon të humbasë vlerë, lejohet shitja e përshpejtuar. Tipologjia dhe problematikat e pasurive janë dinamike dhe për rrjedhojë edhe mënyra e administrimit varion nga pasuria në pasuri gjithmonë pa cënuar integritetin e proçesit.		
		3. Cilat janë rreziqet kryesore gjatë administrimit?		**1. Rreziqet kryesore për pasuritë e paluajtshme janë:** • Mosmirëmbajtja e objektit (dëmtime strukturore, lagështi, amortizim).		

				• Mosshfrytëzimi i pronës për periudha të gjata. • Rënia e çmimit të tregut. • Pretendime nga palë të treta mbi pronësinë. • Hipoteka, barrë tatimore apo kontrata ekzistuese. • Vendim përfundimtar gjyqësor që urdhëron kthimin e pronës, duke krijuar detyrim për kompensim nëse prona është dëmtuar. • Uzurpimi i pronës. • Shfrytëzim pa kontratë të rregullt. • Konflikte pronësie mes bashkëpronarëve. • Ndërtim apo ndërhyrje pa leje në pronë. • Humbja e vlerës monetare për shkak të inflacionit. **2. Rreziqet kryesore për pasuritë e luajtshme janë:** • Rreziku i amortizimit për automjetet, për pajisjet teknologjike dhe humbja e vlerës së objekteve. • Rreziku i skadimit dhe prishjes së mallrave të konsumit të përditshëm. • Rreziku i dëmtimit ose zhdukjes, i vjedhjes ose humbjes të pasurive gjatë ruajtjes.		

				• Rënie e çmimit të tregut para shitjes. • Pretendimet nga palë të treta për pronësinë. • Vendim gjyqësor për kthimin e pasurisë, duke kërkuar që ajo të jetë e ruajtur në gjendje të mirë. **3. Rreziqet kryesore për pasuritë e luajtshme janë:** • Rreziku i humbjes së vlerës inflacioni (Nëse mjetet monetare mbahen për një kohë të gjatë, ato mund të humbin fuqi blerëse për shkak të inflacionit). **4. Rreziqet kryesore për aksione/subjekte tregtare janë:** • Rreziku i humbjes së vlerës së aksioneve nga luhatjet e tregut, humbjet financiare të shoqërisë dhe rënia e reputacionit të biznesit pas sekuestrimit. • Padi nga kreditorët. **5. Rreziqet kryesore për prova materiale janë:** • Rreziku i dëmtimit fizik (armë, pajisje, dokumente).		

		4.Cilat lloje dominojnë në portofol?		• Rreziku i degradimit, prishje e mostrave biologjike ose materiale të ndjeshme. • Ruajtje në kushte jo të përshtatshme. • Rreziku i humbjes ose zhdukjes. • Vjedhje ose manipulim. Ligji 34/2019 ka forcuar mekanizmat e inventarizimit, sigurimit dhe shitjes së hershme për të minimizuar këto rreziqe duke sanksionuar në ligj procedura më të qarta për regjistrimin dhe dokumentimin e pasurisë, duke obliguar ruajtjen e saj në kushte të sigurta dhe transparente, si dhe duke lejuar shitjen paraprake të pasurive që rrezikojnë të zhvlerësohen ose të shkaktojnë kosto të larta mirëmbajtjeje, me qëllim ruajtjen e vlerës ekonomike dhe mbrojtjen e interesit publik. Sipas praktikës së administrimit nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, në portofolin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara zakonisht dominojnë: Pasuritë e paluajtshme apartamentet, tokat (urbane dhe bujqësore), godinat e biznesit dhe objektet hoteliere. Këto pasuri kanë		

		Si administrohen këto pasuri?		vlerën më të lartë monetare krahasuar me kategoritë e tjera. Më pas dominojnë pasuritë e luajtshme (automjetet, makineri dhe pajisje elektronike). Shumat monetare dhe prova materiale të tipit bizhuteri. Administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) bëhet sipas **Ligjit Nr. 34/2019** dhe ndryshon në varësi të natyrës së pasurisë. (A) Për pasuritë e paluajtshme dhe ato të luajtshme, ato mund: • të jepen me qira përmes procedurave transparente; • të përdoren nga institucione publike; • të mbeten në ruajtje nëse ka konflikt juridik; • të jenë objekt i procedurave për largimin e uzurpuesve. • Në rast të statusit të paqartë pronësie, administrimi vazhdon pa cenuar të drejtat e		

				palëve deri në vendim përfundimtar gjyqësor. (B) Për shumat monetare dhe aksionet/subjekte, ato mund: • Të vendosen në depozitë bankare; • Shumat monetare mund të konvertohen për të mos humbur vlerën e tyre për shkak të inflacionit ose luhatjeve valutore; • Monitorohen rregullisht për të parandaluar humbjet ose keqpërdorimin; • Administratorët që emërohen të përkohshëm në subjektet tregtare marrin vendime të kontrolluara për operacionet dhe financat e kompanisë, për të ruajtur vlerën dhe aktivitetin ekonomik.		
		LLOGARITË BANKARE / SHUMAT MONETARE **A i administron realisht AAPSK këto shuma?**		Po. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) në zbatim të **Ligjit Nr. 34/2019** ka në administrim të saj edhe pasuritë shumat monetare të sekuestrua apo konfiskuara subjekteve të ndryshëm.		

				Sipas Ligjit 34/2019, shumat monetare depozitohen në llogari të posaçme dhe nuk qëndrojnë thjesht të ngrira. Shumat monetare depozitohen në llogari bankare të veçanta zyrtare në emër të AAPSK. Pasuritë e luajtshme, në formë të mjeteve monetare, investohen në bono thesari ose depozitohen në llogari bankare të caktuara. Çdo lëvizje dokumentohet dhe kontrollohet për të parandaluar keqpërdorimin. Përdoren vetëm për shpenzime të administrimit ose sipas vendimeve të gjykatës. AAPSK mund të ndërmarrë edhe masa të konvertimit ose investimit të përkohshëm në mënyrë të sigurt për të ruajtur vlerën.		
		Si raportohen këto shuma?		Shumat monetare që administron Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara raportohen sipas **Ligjit Nr. 34/2019** në mënyrë **të detajuar, transparente dhe periodike**		

				Raportohen si: • "Stock" (gjendja në fund të vitit); • "Flow" (të ardhurat gjatë vitit). Kjo shmang numërimin e dyfishtë dhe garanton transparencë.		
		Si shmanget humbja nga inflacioni?		Ligji lejon depozitim në valuta më të qëndrueshme, depozita me afat të shkurtër ose llogari bankare me interes të garantuar për ruajtjen e vlerës monetare.		
		PROVAT MATERIALE **Çfarë përfshin praktikisht kjo kategori?**		Kategoria e **provave materiale** në kontekstin e administrimit nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara përfshin **të gjitha objektet fizike që kanë rëndësi si prova në një procedurë penale ose gjyqësore**. Praktikisht, kjo kategori mund të përfshijë: Pajisje elektronike, automjete, objekte kriminale (armë etj), dokumente identiteti dhe prova të shkruara, mostra biologjike ose		

				materiale (çdo send tjetër i vlerësuar nga organi akuzës).		
		Ku ruhen dhe kush paguan magazinimin?		Sipas praktikës së Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe **Ligjit Nr. 34/2019**; provave materiale u sigurohet **depozitimi në ambiente të sigurta**, të dedikuara për këtë qëllim. Shpenzimet e magazinimit mbulohen nga **buxheti i AAPSK-së**, që nuk është pjesë e financave të buxhetit të shtetit. Në raste të veçanta, kur provat janë të lidhura me kostot e administrimit të pasurisë së sekuestruar, **ligji mund të lejojë që të përdoren mjete të sekuestruara për shpenzime të administrimit**, gjithmonë në mënyrë të kontrolluar dhe transparente. AAPSK ka magazinat e saj, si dhe në varësi të tipologjisë ka siguruar me qera mujore depozitimin të lëndëve djegëse në depozita në vende të dedikuara.		
		Si vlerësohen kur rezultojnë "pa vlerë"?		Zakonisht vlerësimi bëhet me anë të një **vlerësim teknik ose ekspertizë** nga ekspert të fushës për të përcaktuar nëse prova ka		

		SUBJEKTE TREGTARE / AKSIONE **Si administrohet një shoqëri e sekuestruar?**		vlerë ekonomike, tregtare ose koleksionuese. Nëse konkludohet se pasuria nuk ka vlerë ekonomike, ndiqen procedurat për asgjësim ose nxjerrje jashtë përdorimit, sipas ligjit. Në rast administrimi të zakonshëm, rast pas rasti vlerësimet bëhen edhe nga administrator i pasurisë sipas referencave të tregut apo faqeve WEB. Administrimi i një **shoqërie të sekuestruar** nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara bëhet sipas **Ligjit Nr. 34/2019** dhe përfshin masa të veçanta për të ruajtur vlerën ekonomike dhe funksionimin e Shoqërisë Tregtare. • AAPSK emëron një **administrator të përkohshëm** me eksperiencë në menaxhimin e biznesit. • Administratori ka detyrë të mbajë funksionimin normal të shoqërisë, pa ndërhyrë në pronësinë finale. • Regjistrohen të gjitha asetet, detyrimet, kontratat dhe pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të shoqërisë.		

		Çfarë ndodh me fitimet gjatë administrimit?		• Bëhet vlerësim financiar i kompanisë për të përcaktuar **vlerën ekonomike dhe potencialin për të gjeneruar të ardhura**. • Vendimet kryhen në mënyrë të kontrolluar për të **ruajtur vlerën dhe stabilitetin e biznesit**. • Administratori raporton rregullisht tek AAPSK për **gjendjen financiare dhe operacionale** të shoqërisë. • AAPSK monitoron vendimet për të siguruar **ligjshmëri, transparencë dhe mbrojtje të interesit publik**. Gjatë administrimit të një **shoqërie të sekuestruar**, fitimet që gjeneron Shoqëria Tregtare **administrohen nga AAPSK** me qëllim ruajtjen e vlerës ekonomike dhe mbulimin e shpenzimeve të administrimit. Fitimet depozitohen në fond të posaçëm dhe mbeten të bllokuara deri në vendimin përfundimtar të formës së prerë. Nëse vendimi i gjykatës i formës së prerë vendos konfiskimin e shoqërisë tregtare → fitimet kalojnë në pronësi të shtetit.		

		AUTOMJETET **Si shmanget amortizimi i tyre?** **Si ndihmon administrimi në evidentimin e pastrimit të parave?**		Nëse vendimi i gjykatës i formës së prerë vendos kthimin e shoqërisë tregtare → fitimet i rikthehen subjektit. Administrimi i automjeteve të sekuestruara nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara përfshin masa specifike për të minimizuar amortizimin dhe zhvlerësimin e tyre. Sipas përcaktimeve të Ligjit 34/2019 i ndryshuar, automjetet ruhen në garazhe ose depo të mbrojtura. Nëse automjeti humb shpejt vlerën e tij (sipas një analize paraprake në momentin e administrimit) parashikohet shitja e përshpejtuar. Gjithashtu mund të lejohet edhe përdorimi nga institucione publike me vendim administrativ dhe raportim periodik. Nuk është kompetencë e AAPSK, pasi ne nuk marrim pjesë në hetimet e çështjes. Nëse evidentohen pasuri të tjera shtesë të cilat nuk janë marrë në shqyrtim gjatë fazës së hetimeve dhe janë evidentuar gjatë		

				periudhës së administrimit, administratori përkatës njofton prokurorin e çështjes.		
		Si janë marrëdhëniet me prokurorinë?		Marrëdhëniet e AAPSK-se me **Prokurorinë** janë **të rregulluara me ligj**, sepse shumë prej veprimeve të AAPSK-së lidhen drejtpërdrejt me procedurat penale dhe konfiskimin e pasurive. Sekuestrimi vendoset nga gjykata me kërkesë të prokurorit në zbatim të Ligjit nr.10192/2009, i ndryshuar. AAPSK merr në administrim pasurinë pasi prokurori nxjerr urdhërin për ekzekutim dhe dërgon raport të hollësishëm, brenda 15 ditëve nga emërimi i tij për Kryeadministratorin dhe autoritetin përkatës që ka vendosur masën e sekuestrimit, për elementet thelbësore të ekzistencës dhe gjendjes së pasurisë së sekuestruar, duke njoftuar njëkohësisht prokurorin e çështjes, kur pasuria është sekuestruar me kërkesë të kësaj të fundit.		
		<u>Nisma ligjore të AAPSK</u> **Projektligji për ndryshime në Ligjin nr. 34/2019**		Roli i AAPSK është administrativ -juridik - ekonomik, dhe jo hetimor.		

				AAPSK ka hartuar dhe propozuar projektligjin për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 34/2019, "Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara", i ndryshuar. Ky projektligj ka synuar: • **Zgjerimin e objektit të ligjit** duke përfshirë jo vetëm pasuritë e sekuestruara nga organet e drejtësisë, por edhe ato të konfiskuara nga pushteti vendor dhe organet administrative, përfshirë ndërtimet pa leje. • **Përfshirjen e pasurive të reja** si kriptomonedhat (monedhat virtuale), duke përcaktuar rregulla të posaçme për administrimin e tyre. • **Krijimin e Fondit të posaçëm për ndërtimet pa leje**, i dedikuar për zhvillimin dhe përdorimin e objekteve të konfiskuara. • **Transferimin e kompetencave të shitjes** së pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara tek vetë Agjencia, duke shmangur vonesat burokratike dhe duke rritur efikasitetin financiar.		

		Projektligji për ndryshime në Ligjin nr. 66/2023		• **Rritjen e kapaciteteve institucionale** për menaxhimin e ciklit të plotë të pasurisë, nga sekuestrimi deri në shitje dhe transferim të të ardhurave. Ky projektligj ka synuar të forcojë mbrojtjen e interesave publike dhe të sigurojë një administrim më të shpejtë, transparent dhe ekonomik të pasurive të sekuestruara/konfiskuara. Në vijim të reformave, AAPSK ka hartuar dhe propozuar projektligjin për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 66/2023, "Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social". Ky projektligj ka sjellë: • **Centralizimin e kompetencave** pranë AAPSK-së, duke e përcaktuar si organ unik përgjegjës për administrimin dhe zhvillimin e objekteve të konfiskuara. • **Krijimin e Grupit të Punës** si strukturë e përhershme teknike për vlerësimin e		

				gjendjes juridike, teknike dhe financiare të objekteve. • **Ngritjen e Regjistrit të Objekteve të Konfiskuara**, për të garantuar transparencë dhe akses publik. • **Thjeshtimin e procedurave ligjore dhe teknike**, përfshirë dhënien e lejeve të zhvillimit dhe ndërtimit, si dhe rregullimin e procedurave të shitjes përmes ankandit publik. • **Përcaktimin e qartë të përgjegjësive ligjore dhe financiare** të subjekteve zhvilluese, zbatuese dhe mbikëqyrëse pas konfiskimit. • **Krijimin e fondit të veçantë/të dedikuar për ndërtimet pa leje**, i cili siguron financimin e qëndrueshëm për përfundimin dhe përdorimin e objekteve të konfiskuara. Ky projektligj ka adresuar problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të ligjit ekzistues, si fragmentimi i kompetencave, mungesa e transparencës dhe vështirësitë në financim, duke ofruar një model të ri të qartë, efikas dhe të qëndrueshëm.		

2.	03.03.2026	Përshëndetje. Në vijim të komunikimit me ju si institucion dhe duke ju falënderuar për kthim përgjigjjet e deritanishme jeni të lutur të më vendosni në dispozicion të dhënat sa vijon: 1.Jeni të lutur të më nisni të detajuar listën e 1092 pasurive, provave, mjeteve motorike, pasuri të paluajtshme të pamarra ende në dorëzim nga Agjensia, sipas zërave përkatës 2.Çfarë vlere financiare kanë në total? 3.Çfarë është vendosur me qytetarin e kërcënuar nga pronari për lirimin e ambientit të marrë me qira? 4.Sa prej këtyre pasurive nën sekuestro/të konfiskuara janë të përfituara nga korrupsioni, shpërdorimi i detyrës apo tenderat?	13.03.2026	Përshëndetje, referuar kërkesës tuaj ju informojmë si më poshtë vijon: - Bashkëlidhur gjeni tabelën me të dhënat përkatëse lidhur me listën e 1092 pasurive që nuk janë marrë ende në dorëzim nga Agjencia. -Këto pasuri nuk janë të vlerësuara financiarisht, pasi aktualisht nuk administrohen nga AAPSK. - Në lidhje me qytetarin e kërcënuar nga pronari për lirimin e ambientit të marrë me qira, pas referimit të rastit dhe ndërhyrjes së autoriteteve kompetente, palët kanë arritur mirëkuptim ndërmjet tyre dhe situata është normalizuar. Qytetari ka vijuar marrëdhënien e tij kontraktore me Agjencinë dhe nuk janë konstatuar episode të tjera të ngjashme. -Në lidhje me aktakuzat për pasuri nën sekuestro /të konfiskuara, që janë të përfituara nga korrupsioni, shpërdorimi i detyrës apo tenderat, bëjmë me dije Agjencia nuk ka në dispozicion informacion për pasuritë që ende nuk janë marrë në dorëzim.	Me email	Pa pagesë

		Duke ju falenderuar përzemërsisht për ndihmën dhe bashkëpunimin që po tregoni, konfirmoj se e mora emailin. Por ndërkohë, në lidhje me pasuritë e pamarra në dorëzim; 1.Cilat janë propozimet që ka bërë Agjensia për të mundësuar marrjen e pasurive nën dorëzim? 2.Cilat janë arsyet e mosmarrjes në dorëzim të pasurive si rasti i aseteve të F.H dhe të E.M, apo mosmarrje në dorëzim të aseteve apartamente në Vlorë dhe Sarandë?		Përshëndetje, Në vijim të kërkesës suaj, ju informojmë si më poshtë: 1.Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, në zbatim të detyrimeve ligjore, ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për marrjen në dorëzim dhe administrimin e pasurive, përfshirë bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse. Sqarojmë se Agjencia vepron vetëm mbi bazën e vendimeve gjyqësore të komunikuara zyrtarisht dhe të ekzekutueshme, dhe nuk ka kompetencë të propozojë marrjen në administrim të pasurive që nuk i janë kaluar ende. 2.Në lidhje me mosmarrjen në administrim të pasurive të shtetasit F.H, sqarojmë se, me vendimin nr. 1532, datë 24.09.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, është vendosur pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 53, datë 20.03.2024 të Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Në këto kushte, në zbatim të këtij vendimi, pasuritë në fjalë nuk janë marrë në administrim nga ana e Agjencisë.	Me email	Pa pagesë

				Sa i përket pasurive të shtetasit E.M, rezulton se çështja është në proces verifikimi dhe ndjekjeje sipas procedurave ligjore përkatëse. Lidhur me pasuritë e tjera, sqarojmë se administrimi i tyre është i lidhur drejtpërdrejt me statusin juridik të vendimeve gjyqësore përkatëse. Në rastet kur vendimet janë të formës së prerë dhe nuk ekzistojnë pengesa ligjore për ekzekutimin e tyre, Agjencia vijon me procedurat për marrjen në administrim të pasurive. Në të kundërt, në rastet kur ka vendime pezullimi apo procese gjyqësore në vijim, administrimi i këtyre pasurive nuk mund të realizohet deri në një vendimmarrje përfundimtare nga organet kompetente. Duke ju falenderuar për interesimin,		
3.	08.04.2026	Kërkesë për informacion publik mbi vendimmarrjen për zhvendosjen e mbetjeve të dyshuara si të rrezikshme- Nga Media Amfora Në vijim të një kërkese për informacion drejtuar	15.04.2026	Përshëndetje, Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, paraqitur në bazë të legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit, ju bëjmë me dije si më poshtë: 1. Zhvendosja e kontenierëve në zonën e Shënavlashit është kryer nga Agjencia e	Me email	Pa pagesë

		Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nga përgjigjja e kësaj të fundit rezulton se vendimmarrja dhe procedurat për zhvendosjen dhe ruajtjen e kontenierëve të sekuestruar me mbetje të dyshuara si të rrezikshme në Durrës janë në kompetencë të institucionit tuaj. Në këtë kuadër, në bazë të ligjit për të drejtën e informimit, kërkojmë informacion mbi: 1. Kush ka marrë vendimin për zhvendosjen e kontenierëve në zonën e Shënavlashit? 2. Në cilin akt administrativ mbështetet ky vendim (urdhër/vendim/shkresë) dhe cila është data e tij? 3. Cilat institucione apo struktura kanë qenë të përfshira në këtë vendimmarrje? 4. Cilat kanë qenë arsyet dhe kriteret për përzgjedhjen e kësaj zone për vendosjen e kontenierëve?		Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, në përputhje me ligjin nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara”, në kuadër të ushtrimit të funksioneve për ruajtjen dhe administrimin e këtyre pasurive. 2. Vendimi për zhvendosjen e kontenierëve është mbështetur në aktin administrativ të datës 26.02.2026 të Autoritetit Portual Durrës, në të cilën është kërkuar bashkëpunimi i institucionit tonë për lirimin e hapësirës. 3. Në këtë proces kanë qenë të përfshira edhe strukturat e Policisë së Shtetit, përfshirë Oficerin e Policisë Gjyqësore, në kuadër të garantimit të ligjshmërisë dhe sigurisë gjatë zbatimit. 4. Përzgjedhja e zonës së Shënavlashit është bërë për arsye logjistike dhe operacionale, për shkak të afërsisë me vendndodhjen e zhvendosjes, aksesit të përshtatshëm për transport dhe mundësisë për të garantuar kushtet e nevojshme të sigurisë dhe administrimit. 5. Gjatë qëndrimit në këtë zonë, kontenierët janë objekt i masave të vazhdueshme të sigurisë dhe monitorimit, duke përfshirë ruajtjen nga Policia e Shtetit, praninë fizike të strukturave		

		5. Çfarë masash sigurie dhe monitorimi janë parashikuar për këto materiale gjatë qëndrimit në këtë zonë?		përgjegjëse, si dhe mbikëqyrjen me sisteme kamerash sigurie. Ju faleminderit,		

<table>
<tr>
<td>4.</td>
<td>08.07.2026</td>
<td>Revista Monitor, në bazë të ligjit nr. 190 dt. 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, neni 3, kërkon të informohet në lidhje me:

1.Deri tani, në total sa ka arritur deri tani numri i objekteve (vetëm atyre rezidenciale) të sekuestruara nga Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK)?

2. Sa llogaritet vlera e pasurive te paluajtshme per banim te sekuestruara?

3.Fondi i pronave të sekuestruara si ndahet në numër dhe vlerë sipas qyteteve ?</td>
<td>17.07.2026</td>
<td>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, në bazë të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Numri total i objekteve (vetëm atyre rezidenciale) të sekuestruara që janë në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) është 345.

Vlera e përgjithshme e pasurive të paluajtshme për banim të sekuestruara: 4,625,079,438.86 lekë.

Numri dhe vlera e objekteve rezidenciale të sekuestruara sipas qyteteve paraqiten në tabelën e mëposhtme.

<table>
<tr><th>Qyteti</th><th>Nr</th><th>Vlera (lekë)</th></tr>
<tr><td>Fier</td><td>22</td><td>109,067,990.00</td></tr>
<tr><td>Vlorë</td><td>83</td><td>391,854,876.00</td></tr>
<tr><td>Elbasan</td><td>12</td><td>89,809,108.00</td></tr>
<tr><td>Kavajë</td><td>9</td><td>28,210,740.00</td></tr>
</table>
</td>
<td>Me email</td>
<td>Pa pagesë</td>
</tr>
</table>

		4.A mund të na shpjegoni procedurën ligjore që ndiqet deri në vendosjen e masës së sekuestros mbi një pasuri? Cili është roli i SPAK, i Gjykatës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK)? Kur hyn në administrim një pronë nga AAPSK dhe a vendoset sekuestrimi vetëm me vendim gjykate?				

Durrës	30	407,614,390.00
Lezhë	8	3,785,600.00
Sarandë	14	62,318,050.00
Himarë	2	Ska sipërfaqe të përcaktuar
Delvinë	1	3,584,500.00
Berat	14	34,385,012.00
Kamëz	2	11,741,600.00
Cërrik	1	2,367,706.00
Pogradec	2	5,693,590.00
Shkodër	3	13,208,080.00
Tiranë	142	3,461,438,196.86
Total		4,625,079,438.86

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) ushtron veprimtarinë e saj në zbatim të Ligjit nr. 34/2019 *"Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara"*, i cili përcakton kompetencat e Agjencisë në administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

Vendosja e masës së sekuestros mbi një pasuri nuk bën pjesë në kompetencat e AAPSK-së. Procedura për vendosjen e kësaj mase rregullohet nga Kodi i Procedurës Penale dhe legjislacioni i posaçëm në fuqi.

				Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) merr një pasuri në administrim, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 34/2019 *"Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara"*, i ndryshuar. Konkretisht, neni 16 i këtij ligji parashikon marrjen në dorëzim të pasurisë së sekuestruar në bazë të vendimit të gjykatës/urdhërit të prokurorit, ndërsa neni 17 rregullon marrjen në dorëzim të pasurisë së sekuestruar me urdhër të lëshuar nga organi administrativ kompetent, sipas fushës së zbatimit të këtij ligji. AAPSK administron dhe mirëmban pasurinë e sekuestruar, duke siguruar ruajtjen dhe, kur është e mundur, rritjen e vlerës së saj ekonomike. Për sa i përket rolit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) dhe të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (GJKKO), sqarojmë se roli dhe kompetencat e tyre janë të përcaktuara nga legjislacioni që rregullon organizimin dhe funksionimin e këtyre institucioneve. AAPSK nuk është institucioni kompetent për të dhënë informacion që lidhen me rolin dhe veprimtarinë e SPAK		

				dhe GJKKO mbi procedurat hetimore apo gjyqësore që çojnë në vendosjen e masës së sekuestros. Për marrjen e informacionit, Ju mund t'u drejtoheni institucioneve përkatëse ose faqeve të tyre zyrtare. Shënim: Për pasuritë në qytetin e Himarës është e pamundur të përcaktohet vlera duke qënë se vendimi për sekuestrimin e tyre nuk ka të dhëna lidhur me një nga komponentët kryesor të vlerësimit të pasurive, sipërfaqen e tyre.		
5.	20.07.2026	Kërkesë për informacion nga Top Channel. Bazuar në të drejtën ndërkombëtare për informim si dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligji Nr. 119/2014, datë 18.09.2014 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare". **1. Sa prona janë të sekuestruara në tërësi?**	03.08.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, në bazë të ligjit nr.119/2014, " Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: Në kuadër të ekzekutimit të vendimeve të gjykatave apo urdhrave të prokurorit për sekuestrimin e pasurive, rezultojnë gjithsej 3,618 pasuri të sekuestruara, nga të cilat 2,500 pasuri janë marrë në dorëzim nga AAPSK-ja, ndërsa 1,118 pasuri ende nuk janë marrë në dorëzim.	Me email	Pa pagesë

		2. Sa prej tyre janë duke u administruar nga shteti dhe vijojnë funksionin e tyre? **3. Sa është përfitimi financiar nga menaxhimi i këtyre pasurive?** **4. Sa objekte janë aktualisht me qira? A mund të kemi një listë të tyre?**		Duke iu referuar pasurive të sekuestruara të marra në dorëzim rezultojnë të jenë 2500 pasuri në administrim nga shteti. AAPSK rrit me 31.7% të ardhurat nga administrimi në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026. AAPSK vijon të shënojë rezultate pozitive në administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Gjatë periudhës janar–qershor 2026, të ardhurat nga qiradhënia arritën në vlerën 131.5 milionë lekë, ose 31.7% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025. Ky rezultat pasqyron administrimin efikas të aseteve dhe angazhimin e AAPSK për të gjeneruar të ardhura në mbështetje të institucioneve ligjzbatuese dhe projekteve me interes publik. Bazuar në të dhënat e administruara dhe pas verifikimit të të dhënave përkatëse, rezulton se gjatë periudhës janar - qershor 2026, janë nënshkruar 245 kontrata qiraje. Lista përmban informacion konfidencial me të dhëna personale për individët dhe nuk mund t'ua vendosim në dispozicion.		

		5. Kush i shfrytëzon objektet, pronari legjitim apo persona të tjerë të përcaktuar nga institucioni juaj?		Pronari legjitim mund të shfrytëzojë objektin vetëm me urdhër të prokurorit, në rastet kur ai provon se nuk disponon një objekt tjetër për banim. Në rastin e personave të tretë, kontratat e qirasë lidhen vetëm pasi këta të fundit kanë paraqitur kërkesë për marrjen me qira të pasurisë dhe kanë plotësuar formularin përkatës, nëpërmjet të cilit deklarojnë se nuk kanë lidhje me subjektin ndaj të cilit është vendosur masa e sekuestrimit të pasurisë.		
		6. Sa objekte nuk janë shfrytëzuar dhe tashmë janë në gjendje të degraduar?		Pasuritë e pashfrytëzuara përbëhen nga objekte të cilat nuk janë dhënë me qira, si dhe nga pasuri të vendosura në përdorim të institucioneve të caktuara, në zbatim të vendimeve të Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar. Lidhur me numrin e objekteve në gjendje të degraduar, nuk mund të jepet një shifër e saktë, pasi gjendja fizike e secilës pasuri përcaktohet rast pas rasti, bazuar në dokumentacionin dhe kartelën përkatëse të pasurisë.		
		7. Sa është kostoja e mirëmbajtjes së këtyre objekteve?		Lidhur me koston e mirëmbajtjes së pasurive, sqarojmë se nuk është e mundur të përcaktohet një vlerë e përgjithshme, pasi shpenzimet e		

				mirëmbajtjes ndryshojnë sipas karakteristikave dhe gjendjes së secilës pasuri. Kostoja përkatëse përcaktohet rast pas rasti dhe evidentohet në kartelën individuale të pasurisë.		
		8. A ka pasur raste që janë ngritur padi ndaj jush për shkak se objekti i sekuestruar e ka humbur vlerën që kishte në momentin e sekuestrimit?		Po, ka pasur një rast në të cilin është ngritur padi ndaj AAPSK-së me pretendimin se pasuria e sekuestruar ka humbur vlerën që kishte në momentin e sekuestrimit. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit.		
		9. Sa prona janë të konfiskuara në tërësi? A mund të kemi një listë të këtyre objekteve?		Në kuadër të ekzekutimeve të vendimeve të gjykatave apo urdhër të prokurorit për konfiskimin e pasurive rezultojnë se janë në total 1033 pasuri. Lista përmban informacion konfidencial me të dhëna personale për individët dhe nuk mund t'ua vendosim në dispozicion.		
		10. Sa prej tyre janë shitur në ankand online? Cila është procedura e ndjekur?		AAPSK nuk zhvillon ankande online. Nga verifikimi në lidhje me ankandet e kryera rezultojnë të jenë 16 ankande.Të gjitha		

				procedurat e shitjes në ankand zhvillohen në përputhje me Ligjin nr. 9874, datë 14.02.2008, "Për ankandin publik", si dhe me VKM nr. 888, datë 14.12.2016, "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe zhvillimit të ankandit publik". Procedurat zhvillohen duke respektuar parimet e ligjshmërisë, transparencës, barazisë së pjesmarrësve dhe konkurrencës, sipas kuadrit ligjor në fuqi.		
		11. A ka raste që prona është blerë nga i njëjti person të cilit i ishte sekuestruar? Cilat janë ato raste?		AAPSK ushtron kompetencat e saj në përputhje me Ligjin nr. 34/2019 "Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara" dhe Ligjin nr. 10192/2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë". Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, gjatë procedurave përkatëse respektohen kërkesat ligjore për shmangien e konfliktit të interesit, duke u plotësuar deklaratat përkatëse të konfliktit të interesit nga personat e përfshirë në proces. AAPSK nuk ka dijeni dhe nuk mban përgjegjësi në lidhje me këtë çështje.		
		12. A ka pasur kontestime të kësaj procedure?				

		13. Nëse i referohemi faqes tuaj online shikojmë ankande për skrap, naftë apo bagëti. Po ankande të tjera nuk janë zhvilluar?		Nuk ka pasur kontestime. Në kuadër të garantimit të transparencës dhe informimit të publikut, AAPSK publikon të gjitha ankandet në faqen zyrtare të institucionit. Në ankand janë nxjerrë pasuri të luajtshme të tipit skrap, naftë, dele (gjë e gjallë) të cilat kanë degraduar për shkak të periudhës se gjatë që kanë qenë në konfiskim dhe eficenca me e mirë është që të kryhen procedurat e ankandit.		

6.	4.11.2026	Kërkesë për informacion nga Top Channel. Bazuar në të drejtën ndërkombëtare për informim si dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligji Nr. 119/2014, datë 18.09.2014 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare". **1. Sa ankande keni zhvillur? A mund të na vini në dispozicion praktikat?** **2.Përse nuk pasqyrohen online të gjitha ankandet?** **3.A ka raste kur mjetet apo pronat e konfiskuara përfundojnë në duart e të njëjtit person të cilit i është konfiskuar?**	10.11.2026	Përshëndetje, Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, në bazë të ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: Janë zhvilluar 10 ankande për pasuri të sekuestruara për periudhën 2025-2026 dhe 12 ankande për pasuri të konfiskuara për periudhën 2025-2026, https://aapsk.gov.al/category/ankande/ Të gjitha ankandet e zhvilluara janë të publikuara online në Buletinin e Njoftimeve Publike në APP sipas përcaktimeve ligjore dhe në web-in zyrtar të AAPSK-së https://aapsk.gov.al/category/ankande/ Jo në asnjë rast nuk janë marrë nga subjektet, pasi është e ndaluar të marrin pjesë në procedurat e ankandit sepse është e përcaktuar sipas bazës ligjore që subjekti të cilit i janë konfiskuar ose sekuestruar pasuritë apo të afërtit e tij nuk mund të marrin pjesë në procedurën e ankandit. Çdo pjesëmarrës në procedurat e ankandit nënshkruan një deklaratë konflikti interesi sipas ligjit 34/2019 "Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara" dhe Ligjit Nr. 10192/2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit,	Me email	Pa pagesë

		4.Cilat janë problematikat kryesore me të cilat përballet institucioni juaj?		korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë". Gjatë zhvillimit të procedurave të ankandit nuk kemi hasur problematika sepse cdo gjë është përpiluar në bazë të rregullave.		